



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 17, datë 20.06.2018

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“REHABILITIMI ME EFIÇENCË ENERGETIKE I KONVIKTEVE TË QYTETIT
STUDENTI NR. 2, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rehabilitimi me Eficiência Energjetike i Konvikteve të Qytetit Studenti Nr. 2, Bashkia Tiranë”, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 9, datë 29.12.2016, me subjekt zhvillues Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËRI I LINJËS
MINISTËRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

